



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Integritet 2022-2026, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me konsultimin publik për Projekt-Planin Komunal për Integritet 2022-2026

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **02.02.2022** deri me datën: **04.03.2022**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **16.02.2022**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit e cila gjendet në objektin e ri të administratës komunale, me fillim në ora **10:00**.

Duke u bazuar në Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/55 i datës: 21.01.2022 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19. Nenit 26 pikave 26.1 dhe 26.2.

26. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Vendim, lejohen grumbullimet në ambiente të mbyllura deri në tridhjetë (30) persona (punëtori, mbledhje, seminare, trajnime apo grumbullime tjera). Përveç atyre nën moshën 12 vjeçare, obligohen pjesëmarrësit që të posedojnë ndonjëherë nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 dhe pikën 26.2 në mënyrë që të ju lejohet hyrja në këto ambiente, si dhe organizatori obligohet të siguroj distancën fizike prej një (1) metër në mes të personave dhe kontrollimin e dëshmimeve përkatëse si:

26.1 Certifikatën e vaksinimit me së paku dy doza ose një dozë të vaksinës Janssen kundër COVID-19;

26.2 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundër indikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi, duhet të paraqesin testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më të vjetër se 48 orë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën **28.02.2022** në ora **16:00**, tek zyrtarët: Blerta.Gashi@rks-gov.net; Skender.Hamza@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net. Për më shumë detaje, për Planin Komunal për Integritet 2022-2026, mund gjeni në vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqe zyrtare: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>

Platformë për Konsultime Publike: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>

Facebook: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna>

Haziz Krasniqi

Haziz Krasniqi
Zyrtar për Informim

